



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 28 Dt. 13. 02. 2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE”- SUBJEKTIT “CR POWER 2016” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”,të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni, për paisjen me autorizim të subjektit “CR POWER 2016” SH.P.K me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit ““CR POWER 2016” sh.p.k me administrator Z.Avenir ALLUSHI , për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Thatë**, degë e Lumit Zalli i Bulqizës , për prodhim energjie elektrike në Fushë- Bulqizë,Njësia Administrative Fushë- Bulqizë ,Bashkia Bulqizë , Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti , objekti **HEC TEZALLE 2** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X – 44 40 250 ; Y – 45 97 106 ; Z – + 841.91m

Koordinatat e godinës së centralit: X – 44 40 804; Y – 45 98 006; Z – + 656.15 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X – 44 40 804; Y – 45 98 006; Z – + 656.15 m

Prurja mesatare e përroit: $Q_{mes} = 0.136 \text{ m}^3/\text{sek}$;

Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret nga subjekti: $Q_{llog} = 0.25 \text{ m}^3/\text{sek}$;

Prurja ekologjike: $Q_{ekol} = 0.027 \text{ m}^3/\text{sek}$;

Prurja që shkarkohet: $Q = 0.25 \text{ m}^3/\text{sek}$.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETARI
Martin PLLUMBI

KRYETARI
Paulin RADOVANI